



PËLQIM PËR DHËNIEN, RUAJTJEN, PROCESIMIN DHE TRANSFERIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE

Kjo formë e pëlqimit është e përgatitur nga SIGAL UNIQA Group Austria sh.a.. Për qëllime të këtij pëlqimi subjekt i të dhënave është nënshkruesi i kësaj forme ndërsa Sigal Uniqa është marrës dhe përpunues i të dhënave.

Unë deklaroj, me vullnetin tim të lirë jap pëlqimin tim të pakushtëzuar dhe shprehimor që Kompania e Sigurimeve SIGAL UNIQA Group Austria sh.a. (tutje “SIGAL UNIQA”) të marrë, ruajë, përpunojë, procesojë dhe transferojë të dhënat e mia personale dhe të dhënat e ndjeshme personale (biometrike, gjenetike, shëndetësore) në formë elektronike dhe/ose fizike për qëllimet si në vijim:

- Për të gjithë procesin marrjes në sigurim dhe shitjes, si dhe lëshimin e policës/ave të sigurimit dhe menaxhimin e policave të mia të sigurimit; si dhe procesin e mëvoshëm në rast të aplikacioneve të reja nga ana ime për produktet e sigurimit të ofruara nga SIGAL UNIQA;
- Për trajtimin dhe vlerësimin e kërkesave për dëmshpërblim, duke përfshirë marrjen e informacionit lidhur me të dhënat e mia personale dhe ato të ndjeshme personale të nevojshme për trajtimin e kërkesave të mia për dëmshpërblim nga palë të treta që disponojnë këto të dhëna si për shembull: institucione mjekësore/shëndetësore, kompani të tjera të sigurimeve në Kosovë dhe jashtë Kosovës pa kufizim, kompani të ndryshme të shërbimeve dhe asistencë si vlerësues të licencuar për ekspertiza dhe të tjera;
- Për trajtimin dhe vlerësimin të çfarëdo kërkesë tjetër të dorëzuar në SIGAL UNIQA që ndërlidhet ose ka të bëjë me të dhënat e mia të dhëna dhe të dorëzuara në SIGAL UNIQA në lidhje me produktet e sigurimit ose kërkesat për dëmshpërblim ose të lidhura me to;
- Për të kryer marketing dixhital të drejtpërdrejtë për produktet dhe shërbimet e ofruara nga SIGAL UNIQA në çdo kohë;
- Për të më kontaktuar përmes postës, telefonit, SMS-ve, postës elektronike ose mjete të tjera, sipas udhëzimeve të mia të dhëna në SIGAL UNIQA për të gjitha çështjet e kontraktuara, të rëna dakord, të njoftuara nga unë ose kërkesat e dorëzuara nga ana ime për dëmshpërblim ose rimbursim;
- Për qëllime tjera sigurimi, për qëllime risigurimi dhe qëllime statistikore nga SIGAL UNIQA.

Gjithashtu, konfirmoj se unë jam informuar dhe njoftuar që SIGAL UNIQA do të mbledhë, ruajë, përpunojë dhe transferojë të dhënat e mia personale në formë elektronike dhe/ose të shtypur vetëm për qëllimin për të cilin janë mbledhur dhe vetëm për kohëzgjatjen e kërkuar me legjislacionin përkatës në fuqi.

Të drejtat e mia personale siç janë: e drejta të njihem me të dhënat e mia personale dhe të dhëna të ndjeshme personale; e drejta ime për qasje të pakufizuar në të dhënat e mia personale; e drejta për të korrigjuar, ndryshuar dhe/apo fshirë (harruar) të dhënat e mia personale; e drejta për kufizimin e të dhënave të mia personale; e drejta për tu njoftuar për shkeljen të të dhënave të mia personale; e drejta që të njoftohem për transferimin e të dhënave; e drejta për të kundërshtuar përpunimin e të dhënave personale ose vendimmarrjen e automatizuar nga SIGAL UNIQA; e drejta që të kërkoj sqarime dhe informacione nga Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave pranë SIGAL UNIQA; e drejta për paraqitjen e ankesës në Agjencinë për Informim dhe Privatësisë, e drejta që në çdo kohë të tërhiqem nga pëlqimi i dhënë, më janë njoftuar dhe komunikuar qartë nga SIGAL UNIQA si të drejta të garantuara me ligjin në fuqi në Republikën e Kosovës për mbrojtjen e të dhënave personale.

SIGAL UNIQA me pëlqimin tim të pakontesueshëm autorizohet që dhënat e mia personale t'i transferojë tek palët e treta në rastet kur kërkohet ose nevojitet për ekzekutimin e transaksioneve ligjore të kontraktuara ose të dakorduara midis meje dhe SIGAL UNIQA, duke përfshirë por pa u kufizuar ndonjë anëtar të UNIQA GROUP, ndonjë pale të tretë, si dhe kompanie dhe/ose institucioni tjetër apo organizate ndërkombëtare, përfshirë në vende të treta, në përputhje me ligjin në fuqi në Republikën e Kosovës për mbrojtjen e të dhënave personale.

Pa paragjykuar të drejtën time për tërheqje nga ky pëlqim, unë me vetëdije të plotë e kuptoj dhe pajtohem që tërheqja nga ky pëlqim në asnjë formë nuk do të ndikojë në ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave të mia personale të kryera para tërheqjes së këtij pëlqimi. Andaj konfirmoj me vetëdije të plotë se çfarëdo përpunimi i tillë i të dhënave të mia personale dhe të ndjeshme personale ngelet me efekt të plotë juridik dhe i pakthyeshëm.

SIGAL UNIQA më ka informuar dhe njoftuar që ka të emëruar zyrtarin përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale siç kërkohet me ligjin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe kam marrë udhëzime të mjaftueshme që çdo çështje, pakënaqësi ose shqetësim timin në raport me të dhënat e mia personale ta adresoj në çdo kohë përmes adresës elektronike: personaldata@uniqa-ks.com.

Përfundimisht, me nënshkrimin e këtij pëlqimi, unë e konfirmoj që e kam lexuar me vëmendje dhe kam kuptuar në tërësi përmbajtjen e këtij pëlqimi, dhe me vullnet të plotë e të shprehur lirshëm, e autorizoj Kompaninë e Sigurimeve SIGAL UNIQA Group Austria sh.a. për të mbledhur, ruajtur, përpunuar, transferuar dhe bartur të dhënat e mia personale, siç është përcaktuar në këtë pëlqim dhe në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe aktet nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.